LIGJ
Nr. 50/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9928, DATË 9.6.2008 "PËR SHËRBIMIN SHËNDETËSOR STOMATOLOGJIK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9928, datë 9.6.2008 "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 7, shkronja "b" shfuqizohet.

Neni 2

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8
Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit

Mbikëqyrja për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj, në shërbimin shëndetësor stomatologjik, kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"".

Neni 3

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Autoriteti përgjegjës për vënien dhe ekzekutimin e gjobave është inspektorati që mbulon fushën e shëndetit.".

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Masa e gjobës është dënim kryesor. Masa e ndërprerjes së veprimtarisë, sipas shkronjës "a" të këtij neni, është dënim plotësues dhe masa e mbylljes së veprimtarisë, sipas shkronjës "b" të këtij neni, është dënim kryesor.".

Neni 4

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10
Ankimi

Ndaj vendimit të inspektoratit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.".

Neni 5
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 8009, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani